

VENDIM
Nr.233, datë 23.3.2011

PËR MIRATIMIN E FORMËS SË RAPORTEVE, TË MËNYRËS SË BOTIMIT TË TË DHËNAVE PËR PAGESAT E TAKSAVE VENDORE DHE KOMBËTARE NË SEKTORIN MINERAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE TË NIVELIT TË KONFIDENCIALITETIT NË KUADËR TË NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 pika 5, 51 pika 3, e 56 pika 1 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të dhënat për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare botohen e bëhen publike në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

2. Shpërndarja e raporteve realizohet në përputhje me kërkesat e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe strategjinë e komunikimit të kësaj nisme.

3. Bërja publike e raportit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) bëhet çdo 6 (gjashtë) muaj, në formë broshure, në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për industrinë nxjerrëse dhe atë të Nismës për Transparencë për Industrinë Nxjerrëse dhe realizohet në përputhje me kërkesat e kësaj nisme.

4. Formulari i raportimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nga kompanitë minerare është i përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Formulari i raportimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nga institucionet shtetërore është i përcaktuar në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Raporti përmblledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse duhet të përmbajë informacion në plotësim të kushteve të mëposhtme:

a) Përfshirjen e shoqërisë civile, të medias e të komuniteteve të rajoneve minerare në procesin e hartimit e të diskutimit të tij.

b) Përmirësimet ligjore për heqjen e pengesave për zbatimin e kësaj nisme.

c) Përfshirjen, në mënyrë progresive, të të gjitha kompanive që kryejnë veprimtari minerare.

ç) Garantimin që raportet e kompanive të jenë sipas standardeve ndërkombëtare dhe EITI-së.

d) Garantimin që raportet e institucioneve shtetërore të jenë sipas standardeve ndërkombëtare dhe EITI-së.

dh) Duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e auditimit, të përcaktuara nga sekretariati i EITI-së dhe të marrë në konsideratë sugjerimet e këtij auditimi.

e) Duhet të përditësohet nga Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

7. Një ekspert i pavarur, i përzgjedhur në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe kërkesat e Sekretariatit Ndërkombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), harton raportin përmblledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

8. Raporti përmblledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse miratohet nga grupi ndërinstitucional i punës i kësaj nisme, i krijuar me urdhrin nr.156, datë 27.12.2008 të Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës, për ndjekjen e procedurave të kandidimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)”.

9. Raporti përmblledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse diskutohet me shoqërinë civile, median dhe komunitetet e rajoneve minerare dhe reflekton

opinionin e tyre në raportet pasardhëse.

10. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse auditohet nga ekspertë të pavarur, të përzgjedhur sipas procedurave tenderuese në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me kërkesat e sekretariatit të EITI-së.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha